



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Pronën Publike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/54
Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 11 të Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, për ndryshimin/plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1. dhe 1.9 e paragrafit 1. e Vendimit të Qeverisë Nr.06/143 të datës 28.04.2017, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.16/48 të datës 07.12.2020, si në vijim:
 - Znj. Leonora Selmani, Juriste, anëtare e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statutit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ("Komisioni"), caktohet kryetare e këtij Komisioni, kurse
 - Znj. Minire Begaj, kryetare e Komisionit, caktohet anëtare e të njëjtit, e renditur sipas numrit 1.9.
 - Ndryshimi në menaxhim të Komisionit inicohet në qëllim të aktivizimit të rolit të Komisionit dhe adresimit me kohë të kërkesave për njohje të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për kryetar dhe katër (4) anëtarë në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit në këtë përbërje:
 - 1.1. Alban Nevzati, Ekspert Financiar, kryesues;
 - 1.2. Leonita Shabani - Mullarama, Zv.Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, anëtare;
 - 1.3. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.4. Imer Shevelli, Drejtor i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë, anëtar; dhe
 - 1.5. Isuf Zejna, anëtar.
2. Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtarë në Bordin e lartcekur do të zbatojë procedurat e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet 'Njësia për Ekspertizë' në kuadër të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë të Zyrës së Kryeministrit, si strukturë përgjegjëse qeveritare me qëllim të mbështetjes së institucioneve në fusha specifike dhe deficitare, përmes angazhimit të ekspertëve vendorë dhe të huaj.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të 'Njesisë për Ekspertizë' janë si në vijim:
 - Identifikimi i nevojave të institucioneve publike për ekspertizë dhe të tregut të ekspertëve brenda dhe jashtë vendit;
 - Administrimi i procesit të angazhimit të ekspertëve me qëllim të përmbushjes së kërkesës për ekspertizë përmes ofertës së tregut;
 - Detyra dhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe nga menaxhmenti i ZKM-së.
3. Me qëllim të funksionalizimit të kësaj strukture, në pajtim me Ligjin e Buxhetit për vitin 2022, Qeveria zotohet të ndajë mjete financiare në shumë deri në 1,000,000 € (një milion euro) të cilat do të shfrytëzohen për nevojat e njësisë dhe angazhimin e ekspertizës, sipas legjislacionit të aplikueshëm.
4. Deri në funksionalizimin e plotë të kësaj njësie, me buxhet të ndarë dhe/ose si program buxhetor, strukturat përgjegjëse (Zyrat) brenda Zyrës së Kryeministrit ofrojnë shërbimet e nevojshme mbështetëse sipas detyrave dhe përgjegjësive të punës, ndërsa aktivitetet e Njesisë financohen nga ndarjet buxhetore aktuale të programit buxhetor 10600 - Zyra e Kryeministrit.
5. Për ekzekutimin e buxhetit lidhur me funksionimin e strukturës nga pika 4. nga Thesari i Kosovës (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) krijohet një nën-program me kod të veçantë, në kuadër të programit 10600 - Zyra e Kryeministrit, organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, përmes të cilit alokohet buxheti për shpenzim, evidentohen dhe raportohen të gjitha shpenzimet e ndodhura për funksionimin e Njesisë.
6. Njësia do të përbëhet nga një staf i nevojshëm për funksionim të Njesisë, në kuadrin e numrit të lejuar të stafit të organizatës buxhetore, sipas termave të referencës dhe përshkrimit të detyrave të punës që do të përcaktohen sipas pikës 7. të këtij Vendimi.


7. Niveli i organizimit të kësaj njësie, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e detajuara, e të ngjashme, përcaktohen me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Zyrës së Kryeministrit dhe Rregulloren e Punës së Qeverisë.
8. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Njësia për Ekspertizë themelohet si rezultat i ngecjeve në zbatimin e politikave të Qeverisë për shkak të mungesës së kapaciteteve të specializuara në fushat përkatëse. Pas një hulumtimi preliminar të ndërmarrë nga Zyra e Kryeministrit është identifikuar nevoja e institucioneve të Qeverisë për 45,000 ditë pune për ekspertizë. Në mënyrë që të tejkalohet ngecja e lartcekur, duhet të krijohet një mekanizëm i cili do të lehtësojë përmbushjen e nevojës për ekspertizë, rol ky që do të përmbushet nga struktura e dedikuar për Ekspertizë. Ekspertët do të angazhohen në përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të politikave, planifikimit dhe zbatimit të projekteve si dhe në rolin këshillëdhënës të ekzekutivit. Po ashtu, funksionalizimi i kësaj strukture do të mundësojë angazhimin e kuadrove të specializuar nga diaspora dhe të thellojë bashkëpunimin me ta.

Duke u bazuar në këto arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Vendimi për rritjen e shumës së përfitimit të skemave pensionale të financuara nga shteti, nga shumat aktuale në shumën prej 100,00 € (njëqind euro), për skemat dhe nën-programet si në vijim:
 - 1.1. Pensionet bazike – sociale, me kod buxhetor 00100;
 - 1.2. Pensionet e aftësisë së kufizuar, me kod buxhetor 00200;
 - 1.3. Pensioni familjar, me kod buxhetor 002900; dhe
 - 1.4. Pensioni invalidor i Punës, me kod buxhetor 003000.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në zbatim të paragrafit 4 të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e specialistëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere programi Aftësimi Specialistik dhe EVM me kod 90300, prej datës 1 janar 2022 deri me datë 31 gusht 2022.
2. Numri i specialistëve me vetëfinancim është 580 dhe përkrahja financiare për muajt janar-gusht 2022 është në vlerë prej 2,748,560.00 € (dy milionë e shtatëqind e dyzetetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë euro).
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera relevante të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në bazë të Rekomandimit të Raportit të Komisionit Evropian të datës 06.10.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:


V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (këtu e tutje "Këshilli").
2. Këshilli është përgjegjës për përcjelljen e zbatimit të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit për ndryshime klimatike në përputhje me angazhimet në kuadër të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike (UNFCCC-së), Marrëveshjes së Parisit dhe Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.
3. Këshilli përbëhet nga:
 - 3.1. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kryesues i Këshillit;
 - 3.2. Ministrja e Ekonomisë, anëtare;
 - 3.3. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 3.4. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 3.5. Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtare;
 - 3.6. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 3.7. Ministri i Shëndetësisë, anëtar.
4. Këshilli kryen këto funksione:
 - 4.1. Koordinon aktivitetet për zbatimin e angazhimeve në kuadër të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike (UNFCCC-së), Marrëveshjes së Parisit dhe Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor;
 - 4.2. Siguron që projektet që mund të kenë ndikim në ndryshimet klimatike të realizohen në përputhje me legjislacionin vendor dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
 - 4.3. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në konventa, protokolle dhe marrëveshje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike;
 - 4.4. Bënë përgatitjen dhe dorëzimin e Komunikimit Kombëtar për Sekretariatit të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike (UNFCCC), pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Kombe të Bashkuara (KB) dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Parisit;

- 4.5. Bënë përgatitjen dhe dorëzimin e Kontributit të Përcaktuar Kombëtar (NDC) për Sekretariatit e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Kombe të Bashkuara (KB) dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Parisit;
 - 4.6. Monitoron gjendjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike, politikat sektoriale dhe dokumentet e tjera të planifikimit, nga aspekti i përputhshmërisë me politikën kombëtare dhe propozon masa për zbatimin, koordinimin dhe përmirësimin e politikave, masave dhe aktivitetet në këtë fushë;
 - 4.7. Inicion ndryshimin e politikave, rregulloreve dhe masave në fushën e ndryshimeve klimatike në përputhje me rregulloret dhe standardet e Bashkësisë Evropiane (BE) dhe të Kombeve të Bashkuara (KB), si dhe bënë propozime për vendime të rëndësishme për zbatimin e projekteve përkatëse dhe aktiviteteteve të tjera në fushën e ndryshimeve klimatike.
 - 4.8. Këshilli takohet së paku një (1) herë në vit.
 - 4.9. Këshilli i raporton Qeverisë.
5. Në kuadër të Këshillit funksionon Sekretariati Teknik i cili përbëhet nga:
- 5.1. Përfaqësuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (MMPHI) - kryesues;
 - 5.2. Përfaqësuesi nga Departamenti i Energjisë (ME) - anëtar;
 - 5.3. Përfaqësuesi nga Zyra për Planifikim Strategjik (MFPT) - anëtar;
 - 5.4. Përfaqësuesi nga Departamenti Rrugorë (MMPHI) - anëtar;
 - 5.5. Përfaqësuesi nga Departamenti i Industrisë (MINT) - anëtar;
 - 5.6. Përfaqësuesi nga Departamenti i Pylltarisë (MBPZhr) - anëtar;
 - 5.7. Përfaqësuesi nga Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve (MBPZhr) - anëtar;
 - 5.8. Përfaqësuesi nga Departamenti i Politikave Sektoriale (ZKM/ZBZh) - anëtar;
 - 5.9. Përfaqësuesi nga Institutit Hidrometeorologjik (MMPHI) - anëtar;
 - 5.10. Përfaqësuesi nga Departamenti për Planifikim, Ndërtim dhe Banim (MMPHI) - anëtar;
 - 5.11. Përfaqësuesi nga Departamenti për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave (MMPHI) - anëtar;
 - 5.12. Përfaqësuesi nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (MSh) - anëtar;
 - 5.13. Përfaqësuesi nga Shoqëria Civile - anëtar;
 - 5.14. Përfaqësuesi nga Universiteti - anëtar; dhe
 - 5.15. Përfaqësuesi nga UNDP - anëtar.
6. Sekretariati Teknik kryen këto funksione:
- 6.1. Përgatit takimet e Këshillit;
 - 6.2. Kryen punët profesionale dhe administrativo-teknike për nevojat e Këshillit;
 - 6.3. Takohet së paku dy (2) herë në vit (çdo gjashtë muaj); dhe
 - 6.4. I raporton Këshillit.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen të gjitha institucionet e cekura në këtë Vendim.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05/45 i datës 21.08.20215.

9. Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 39, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme shoqërore N. Sh "OPB Mirusha" e cila preket nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Objektivit të Qendrës për Pajisje me Dokumente dhe Qendrës për Regjistrim të Automjeteve për nevoja të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencia e Regjistrimit Civil, Zona Kadastrale: Malishevë, Komuna e Malishevës, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të Projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronës do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit \Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e Regjistrimit Civil.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/54

Datë: 12.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Agjencionit të Mbrojtjes për Inteligjencë dhe Siguri.
2. Obligohen Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë